



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 344-24328 dt 07.05 2015



Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 29.04.2015 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE TË REJA,
DHE SHQYRTIMIN E KËRKESAVE TË PALËVE DREJTUAR KOMISIONIT**

I. FORMOHET Komisioni për emërtimin e rrugve të reja, dhe shqyrtimin e kërkesave në territorin e Komunës së Drenasit në këtë përberje:

1. Xhavit Drenori
2. Ajet Demiri
3. Rifat Bilalli
4. Hyrije Xhemajli
5. Enver Hajdari

II. Detyrë e Komisionit është që t'i propozojë Kuvendit emërtimin e rrugëve të reja riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave .

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 400-24324 dt 07.05. 2015



Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr 03/L-040, nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 29.04.2015 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR PËRKRAHJEN MATERIALE TE LEHONAVE-NËNAVE NË KOMUNËN E DRENASIT

Neni 1

Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për lehonat/nënat të cilat janë qytetare të Komunës së Drenasit.

Neni 2

Sipas nenit I të këtij vendimi, për çdo lindje të lehonave, të përkrahen me mjete financiare në vlerë prej 100 € (njëqind euro) për lindjet që do të pasojnë gjatë vitit 2016 (duke filluar nga 01/01/2016).

Neni 3

Sipas nenit II të këtij Vendimi gjithashtu të posalindurit të Diagnostifikuar me Sy.Doën, kompensohen me mjete financiare në vlerë prej 500 € (pesëqind euro) gjatë vitit 2016 (duke filluar nga 01/01/2016).

Neni 4

Gjithashtu, sipas nenit I të këtij propozimvendimi do të përkrahen me mjete financiare edhe nënat-lehonat me shtatë (7) e më shumë fëmijë nën moshën 18 vjecare, në vlerë prej 1000 € (njëmijë euro).

Neni 5

Mjetet financiare për këtë qëllim do të sigurohen nga kategoria ekonomike Subvencioneve dhe Transfereve kodi ekonomik 21/21200/73010 të Drejtorisë për Shëndetësisë e M.Sociale pas aprovimit të buxhetit nga ana e Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi prej dites se aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL-al ,ndersa zbatueshmeria e këtij vendimi fillon nga 01/01/2016



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

12 Nr. 400-24317 dt 07.05 2015



Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve e miratuar me dt.29/06/2011 nga Kuvendi Komunal Drenas 01/ Nr.031-6566, dt.30/06/2011 pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi Komunal Drenas për vitin 2015. Me propozim të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit) në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me datën 29.04.2015 aprovoi këtë:

VENDIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1.

Me këtë vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e simpoziumit kushtuar Heroit të Kombit „Shaban Polluzha”

Neni 2.

Projekti i Instituti Kombëtar të Historisë përkrahet me shumën prej 3.000,00€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të këtij projekti.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/200.

Neni 4.


Mjetet financiare do të shërbejnë për pagesën e një pjese të shpenzimeve sipas vlerës së mjeteve nga neni 2.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)

Kuvendi i Komunës

Nr. 463-24785 dt 08.05 2015



Në bazë të nenit 11,12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ,nenit 11 parag.1 Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës se Drenasit (Glllogocit)në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 29.04.2015 miraton këtë:

VENDIM

Për miratimin paraprak të kërkesës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës përfshirë tokën dhe objektet e Stacionit të Autobusëve në Glllogoc në shfrytëzim afatgjatë .

I.

MIRATOHET kërkesa e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë Stacioni i Autobusëve në Glllogoc,me objekte përcjellëse ekzistuese dhe rregullimin e infrastrukturës për përmisimin e kushteve të operimit në dhënien e shërbimeve më të mira shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve në transportin e udhëtareve në linjat ndërrurbane,periferike,urbane,taxi dhe ndërkombëtare në kuptim të Planit Rregullues Urban në kohëzgjatje prej 40 vitesh,në kuptim të nenit 3 parag.1 nenparagrafi 1.4 të Ligjit nr.04/L- 144,përmes konkurimit të hapur.

II.

Në shfrytëzim afatgjatë ipet Palujtshmëria në sipërfaqe prej 01.22,00ha, objektet përcjellëse e atë peronat ,parkingjet e Stacionit të autobusëve dhe objekti i stacionit ekzistues në sipërfaqe prej 167m², e cila gjendet në Zonën kadastrale në Glllogoc,numri i ngastrës 726/15 .

III.

Dhënia e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë sipas pikës II(dy)të këtij Propozimvendimi,bëhet përmes konkursit të hapur publik në kuptim të nenit 6 par.2 të Ligjit nr.04/L-144 dhe kriterëve për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës dhe të nenit 12 të Rregullores QRK nr.23/2013.

IV.

Me këtë Vendim Autorizohët Komisioni për vlerësimin e ofertave t'i ndërmarrë të gjitha procedurat për pregaditjen e mbajtjes së konkursit publik në kuptim të nenit 14 të Rregullores QRK nr.23/2013.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë dita pas regjistrimit ne zyren e protokolit te MPL dhe publikimit në uebfaqen e Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Naim Bazaj